



Funded by
the European Union



DEKLARATË: RIPËRDORIMI I TOKAVE TË KONFISKUARA PËR PROMOVIMIN E BUJQËSISË SOCIALE



Ne, rrjeti mbështetës për menaxhimin e tokave të konfiskuara për qëllime sociale, një platformë gjithëpërfshirëse partneriteti e organizatave të shoqërisë civile, partnerë të projektit Toka Jonë, institucioneve publike vendore dhe qendrore, medias, aktivistëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve rurale të Tiranës, Durrësit dhe Shijakut, **riafirmojmë angazhimin tonë të përbashkët për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të nismave të ndërmarra në kuadër të projektit “Toka Jonë-Ripërdorimi i tokave të konfiskuara për promovimin e bujqësisë sociale”** si dhe çdo nisme tjetër që synon përdorimin e aseteve të konfiskuara për qëllime sociale.

Rezultatet pozitive të projektit Toka Jonë, veçanërisht ndikimi i prekshëm tek të rinjtë, gratë dhe fermerët në komunitetet rurale të Tiranës, Durrësit dhe Shijakut, tregojnë për potencialin e madh që ka kjo qasje në fuqizimin e grupeve të cënueshme të shoqërisë. Përdorimi i tokave të konfiskuara për qëllime sociale ka dëshmuar se mund të gjenerojë ndikim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, duke promovuar gjithëpërfshirjen dhe forcimin e kapaciteteve të të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. **Ne mbetemi të përkushtuar për të ndërtuar mbi këto rezultate dhe për të nxitur përhapjen e këtij modeli edhe në zona të tjera të vendit.**

Bazuar në përvojat e suksesshme ndërkombëtare në ripërdorimin për qëllime sociale të pronave të konfiskuara dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i projektit *Toka Jonë*, besojmë se krijimi dhe funksionimi i një ekosistemi mbështetës ndërsektorial dhe gjithëpërfshirës është një hap thelbësor për të garantuar vijueshmërinë e nismave ekzistuese si dhe përhapjen e modelit të ripërdorimit të tokave të konfiskuara në sipërmarrjen sociale bujqësore në Shqipëri.



Ne inkurajojmë bashkëpunimin ndërinstytucional dhe sektorial ndërmjet institucioneve qendrore, pushtetit vendor, shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale, si domosdoshmëri dhe parakusht për menaxhimin transparent dhe të përgjegjshëm të tokave të konfiskuara me qëllim për të sjellë përfitime konkrete për komunitetet vendore.

Të ndërgjegjshëm si për rëndësinë dhe sfidën e angazhimit komunitar në të gjitha aspektet e jetës publike në nivel vendor, përfshirja e grupeve të ndryshme komunitare merr një rëndësi të veçantë dhe të paanashkalueshëm në menaxhimin efektiv të tokave të konfiskuara për qëllime sociale. Për këtë arsye shprehim gadishmërinë dhe mbështeten tonë ***për përfshirjen aktive dhe të barabartë të komuniteteve në të gjitha hallkat e procesit të menaxhimit të këtyre aseteve.***

Ne inkurajojmë dhe mbështesim institucionalizimin e formave të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare, si forumet e hapura, dialogun komunitar, konsultimet publike etj., si instrumente të nevojshme për të sjellë afër dhe lidhur komunitetet me institucionet publike përgjegjëse për menaxhimin e tokave të konfiskuara dhe vendimarrjen që lidhet me to.

Duke marrë në konsideratë se bujqësia sociale përfaqëson një model inovativ, gjithëpërfshirës dhe rigjenerues të sektorit bujqësor, theksojmë nevojën për përhapjen e modelit të përdorimit të tokave bujqësore të konfiskuara në promovimin e bujqësisë sociale në komunitetet rurale të Shqipërisë për të adresuar sfidat sociale, ekonomike dhe mjedisore me të cilat përballen sot komunitetet vendore. Për këtë, ***kërkojmë vëmendjen e institucioneve përgjegjëse mbi ofrimin e instrumenteve publik financiarë dhe teknik që mbështesin krijimin e sipërmarrjeve sociale bujqësore në toka të konfiskuara dhe promovimin e produkteve të prodhuara nga këto sipërmarrje.***



Në përfundim, ne:

Riafirmojmë përkushtimin dhe gatishmërinë tonë për të ndërmarrë dhe mbështetur nisma që synojnë ripërdorimin e tokave të konfiskuara për zbatimin e modeleve të bujqësisë sociale, duke marrë parasysh se këto nisma përfaqësojnë një mundësi reale për të rigjallëruar zonat rurale dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të komuniteteve rurale, veçanërisht gratë, të rinjtë dhe fermerët e vegjël.

Shprehim gatishmërinë tonë të plotë për të kontribuar aktivisht në ndërtimin e një ekosistemi bashkëpunimi të hapur dhe gjithëpërfshirës, ku institucionet publike, shoqëria civile, komunitetet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë veprojnë në partneritet dhe sinergji për qëllime të përbashkët në avancimin e kësaj kauze. Të bindur se kjo qasje kërkon më shumë se angazhim. Për këtë duhet vullnet politik i qartë, mbështetje e qëndrueshme institucionale dhe investim afatgjatë në këto modele që mund të ndryshojnë pozitivisht situatën e menaxhimit të tokave të konfiskuara dhe qeverisjen e këtij sektori me qëllimin final përdorimin e tyre për të mirën e përbashkët.

I bëjmë thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse, donatorëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar që të bashkohen në këtë përpjekje për të ndërtuar mbi arritjet e deritanishme dhe për të kthyer këtë vizion në një politikë publike të njëmendtë. Vetëm përmes bashkëpunimit të ngushtë për qëllime të përbashkëta mund të arrijmë rezultate të prekshme që jo vetëm sjellin përfitime ekonomike, sociale dhe mjedisore, por forcojnë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve publike, përmirësojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë dhe mbështesin sundimin e ligjit në Shqipëri.

Bashkë mund të krijojmë një Shqipëri më të drejtë, më të barabartë dhe më të qëndrueshme për të gjithë.



Funded by
the European Union



Përfaqësues të Rrjetit Mbështetës:

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD)

Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario/ Koordinimi i

Organizatave për Shërbimin Vullnetar (COSV Albania)

Consorzio Nazionale della Cooperazione di solidarietà sociale Gino

Matterelli-CGM

ADAD Malore

Fondazioni Joscelyn

Ecovolis

Diakonia Agapes Shqipëri

